Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 21 gusht 2012

Nr. i lëndëve 36/09 dhe 37/09

Radislav DEKIÇ dhe Xhevahire MORINA

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 21 gusht 2012,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Paul LEMMENS
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesave të sipërpërmendura, të paraqitura në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas evidentimit të tërheqjes së z. Marek Nowicki nga rasti në pajtim me Rregullën 12 të Rregullores së punës,

Pas diskutimeve vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesat u paraqitën më 18 mars 2009 dhe u regjistruan në të njëjtën ditë.

2. Më 27 korrik 2009, Paneli kërkoi informacione nga Agjencia Kosovare e Pronës (AKP). Më 29 korrik 2009, AKP ofroi përgjigjen e saj.

3. Më 12 shtator 2009, Paneli i bashkoi ankesat, në pajtim me Rregullën 20 të Rregullores së punës së Panelit.

4. Më 25 nëntor 2009, Paneli ia komunikoi ankesat Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) për komentet e UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e ankesave. Më 15 janar 2010, PSSP-ja e ofroi përgjigjen e UNMIK-ut.

5. Më 24 gusht 2011, Paneli ua dërgoi ankuesve komentet e PSSP-së dhe i ftoi ata të paraqesin komentet e tyre nëse dëshironin. Më 20 shtator 2011, Paneli pranoi komentet e tyre.

6. Më 30 nëntor 2011, Paneli ia dërgoi përgjigjen e ankuesve PSSP-së për informim.

II. FAKTET

7. Z. H.S., banor i Kosovës, kishte fituar të drejtën për shfrytëzimin e banesës në vitin 1988 në Prishtinë, rruga Ramiz Sadiku, nga Komisioni për ndarjen e banesave dhe huave i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Banesa ju kishte ndarë atij për shkak të detyrave dhe funksioneve të tij zyrtare me të cilat ishte i ngarkuar brenda Kuvendit.

8. Në vitin 1991, bordi komunal i shoqatave të veteranëve të Unionit Jugosllav ia dha të drejtën znj. Ljubica Dekiç, nënës së z. Radislav Dekiç, për shfrytëzimin e banesës në Prishtinë. Në vitin 1992, në pajtim me këtë vendim, Komisioni për çështje banesore i organeve krahinore të Krahinës Autonome të Kosovës ia ndau asaj banesën e sipërpërmendur në rrugën Ramiz Sadiku. Po në këtë vit, ajo lidhi kontratë për shfrytëzimin e banesës me Ndërmarrjen banesore publike të Prishtinës, dhe hyri në banesë me djalin e saj, z. Radislav Dekiç. Më 1 mars 1993, ajo bëri kontratë për blerjen e banesës me Krahinën Autonome të Kosovës.

9. Znj. Ljubica Dekiç vdiq më 6 gusht 1993. Z. Radislav Dekiç u deklarua trashëgimtari i vetëm i pasurisë së saj, duke përfshirë edhe banesën në rrugën Ramiz Sadiku, në të cilën ai vazhdoi të banonte.

10. Pas konfliktit të vitit 1999, z. Dekiç u largua nga Kosova për shkaqe të sigurisë dhe shkoi për të jetuar në Serbi. Sipas tij, z. H.S. më vonë e ka uzurpuar banesën.

11. Pas ardhjes së UNMIK-ut në Kosovë, u themeluan Drejtoria për Çështje Banesore Pronësore (HPD) dhe Komisioni për Ankesa Banesore Pronësore (HPCC) me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/23 të datës 15 nëntor 1999, për themelimin e Drejtorisë për Çështje Banesore Pronësore (HPD) dhe Komisionit për Ankesa Banesore Pronësore (HPCC). Mandati i HPD-së ishte të rregullojë të drejtat banesore pronësore në Kosovë dhe të zgjidhë kontestet lidhur me pronën banesore. Qëllimi ishte të sigurojë udhëzime të përgjithshme mbi të drejtat pronësore në Kosovë me qëllim të arritjes së zgjidhjeve efektive dhe efikase të ankesave lidhur me pronën banesore. Me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/23 u themelua HPCC si organ i pavarur i HPD-së, përgjegjës për zgjidhjen e kontesteve jokomerciale lidhur me pronën banesore të cilat ia drejtonte HPD, derisa PSSP-ja vendosi se gjykatat vendore ishin të afta t'i kryejnë këto funksione.

12. HPD/HPCC kishin juridiksion për tri kategori të kërkesave/ankesave për pronë banesore: kërkesa/ankesa nga individë të drejtat pronësore, poseduese apo të zotërimit të të cilëve për pronë banesore ishin revokuar pas 23 mars 1989, në bazë të legjislacionit që është diskriminues në zbatimin apo qëllimin e tij (kërkesat e "kategorisë A"); kërkesat/ankesat nga individë të cilët kishin bërë transaksione pronësore joformale pas 23 mars 1989 (kërkesat e "kategorisë B"); dhe kërkesat/ankesat nga individë të cilët në mënyrë të

pavullnetshme i kishin humbur të drejtat e tyre pronësore, poseduese apo të zotërimit të pronave të tyre pas 24 mars 1999 (kërkesat e "kategorisë C").

13. Pasi dëgjoi se z. H.S. ia kishte uzurpuar banesën, z. Dekiç parashtroi kërkesë të "kategorisë C" më 24 maj 2001 pranë HPD, duke kërkuar riposedimin e banesës (kërkesa DS 001970). Më 20 qershor 2001, z. H.S. parashtroi kërkesë të "kategorisë A", duke kërkuar njohjen e të drejtës së tij pronësore për banesën e njëjtë (kërkesa DS002241).

14. Më 9 shtator 2002, z. Dekiç ia shiti banesën znj. Xhevahire Morina. Kontrata e shitjes u verifikua nga Gjykata komunale e Prishtinës më 18 shtator 2002. Menjëherë pasi bëri pagesën e çmimit të blerjes, znj. Morina mori në posedim banesën dhe u vendos në të me vajzën e saj.

15. Në vitin 2004, z. H.S. parashtro ankesë në Gjykatën komunale të Prishtinës kundër znj. Morina dhe vajzës së saj, për hyrjen në pronën që ai pretendonte se i përkiste atij. Ai kërkoi nga gjykata që të urdhërojë të paditurit të lirojnë banesën.

16. Më 26 prill 2004, Gjykata komunale e hodhi poshtë ankesën. Gjykata konstatoi se, kur znj. Morina dhe vajza e saj hynë në banesë, z. H.S. nuk kishte posedim faktik të banesës por përkundrazi ua kishte dhënë me qira tri personave të tjerë.

17. Z. H.S. parashtro ankesë kundër këtij aktgjykimi. Më 8 qershor 2006, Gjykata e qarkut në Prishtinë konsideroi se gjykata e shkallës së parë e kishte vlerësuar drejt gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e kishte zbatuar edhe ligjin. Prandaj ankesa ishte hedhur poshtë.

18. Në ndërkohë, më 22 tetor 2005, HPCC mori vendim për dy kërkesat e sipërpërmendura konkurruese (shih § 13 lart). Vendosi që kërkesa e "kategorisë A" të z. H.S. të pranohet dhe atij t'i kthehen të drejtat pronësore. Mirëpo, për t'u bërë ky urdhër i efektshëm, z. H.S. duhej t'i paguante HPD-së një shumë të parave për banesën, e cila shumë do të përcaktohej nga HPD. Kontrata e blerjes në mes të z. Dekiç dhe znj. Morina ishe shpallur pa forcë ligjore. Si ankues i "kategorisë C", z. Dekiç kishte të drejtë në kompensim për humbjen e pronësisë mbi banesën nga shuma që duhej të paguhej nga z. H.S. Mirëpo, meqë z. Dekić kishte pranuar pagesën nga znj. Morina, ai mund të përfitonte nga sigurimi i kompensimit vetëm pasi t'ia kthente znj. Morina çmimin e blerjes të cilin ai e kishte pranuar sipas shitjes së paligjshme. Nëse z. H.S. nuk do ta paguante kompensimin, ai do të kishte të drejtë në kompensim nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në vend të kthimit të pasurisë, dhe banesa do të mbetej pronë e znj. Morina.

19. Znj. Morina, si palë e interesuar, paraqiti kërkesë për rishqyrtim më 16 korrik 2007. Z. Dekiç paraqiti një kërkesë të tillë më 3 shtator 2007. Të dy ankuesit argumentuan se sipas ligjit në fuqi në atë kohë (Ligji mbi marrëdhëniet banesore, *Gazeta zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës*, nr. 11/93, 29/86 dhe 42/86), ndarja e një banese për shfrytëzim zyrtar nuk rezultonte me të drejtën e zotërimit të zyrtarit. Meqë banesa iu kishte ndarë z. H.S. vetëm për përdorim zyrtar, ai asnjëherë nuk ka fituar të drejtën e zotërimit, dhe për këtë arsye nuk ka pasur një ankesë valide të "kategorisë A".

20. HPCC-ja i hodhi poshtë të dy kërkesat më 19 qershor 2008. HPCC-ja konsideroi se banesa e cila ju kishte ndarë z. H.S. "duket se tanimë ishte shndërruar në banesë të rëndomtë kur (z. H.S.) e posedonte këtë pronë, siç evidentohet edhe me faktin se (ai) kishte mundësi të lidhte kontratë për shfrytëzim – një mjet juridik që nuk është në dispozicion për banesat për shërbim sipas ligjit në fuqi". Znj. Morina e mori vendimin e HPCC më 5 mars 2009, kurse z. Dekiç më 25 mars 2009.

III. ANKESAT

21. Ankuesit, në radhë të parë, thirren në shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ata argumentojnë se HPCC nuk ishte "tribunal", por organ administrativ, dhe se rasti i tyre nuk është dëgjuar publikisht.

22. Ankuesit po ashtu thirren në shkelje të nenit 13 të KEDNJ, meqë atyre nuk iu lejua që të ushtrojnë të drejtën e tyre për një mjet efektiv pranë një organi "nacional".

23. Ankuesit më në fund thirren në shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, meqë ata u privuan nga të drejtat e tyre pronësore në favor të një personi i cili sipas ligjit në fuqi nuk mund të pretendonte një të drejtë valide të zotërimit.

IV. LIGJI

24. Para se të shqyrtohen rastet për bazueshmërinë e tyre, Paneli së pari duhet të vendosë nëse do t'i pranojë rastet, duke marrë parasysh kriteret për pranim të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

25. Në komentet e tij, PSSP-ja e pranon se ankesat në shikim të parë duket se janë të pranueshme. Mirëpo, ai argumenton se ata janë të pabazuara.

26. Në këtë fazë të procedurës, Paneli do të shqyrtojë nëse, në bazë të argumenteve në të cilat thirret PSSP-ja, ankesat në shikim të parë duhet të konsiderohen "të pabazuara", në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, dhe për këtë arsye të shpallen të papranueshme.

Pohimi për shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ

a) Parashtresat e palëve

27. Ankuesit argumentojnë se ankesat e tyre nuk janë vendosur nga një "tribunal", në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ. Sipas ankuesve, HPCC nuk i ka karakteristikat e një gjykate dhe nuk është kualifikuar me asnjë akt si gjykatë. Më saktë, HPCC-ja duhet të konsiderohet si një organ administrativ klasik. Sido që të jetë, që një organ të konsiderohet si "tribunal", ai, në mes tjerash, duhet të jetë organ i përhershëm. HPCC nuk është i tillë, është i jashtëm për sistemin gjyqësor të Kosovës dhe i themeluar në baza *ad hoc*.

28. Ankuesit po ashtu ankohen se rastet e tyre nuk janë dëgjuar publikisht nga HPCC.

29. PSSP-ja argumenton, në radhë të parë, se një "tribunal" në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ, nuk duhet të jetë gjykatë e llojit "klasik". Është e mjaftueshme që është organ i pavarur nga palët dhe është i paanshëm, të cilit legjislacioni nacional i jep pushtetin të nxjerrë vendime të detyrueshme në një fushë të caktuar. Kjo përfshin aspektet lëndore, përkatësisht funksionet gjyqësore të organit, dhe aspektet procedurale, përkatësisht kushtin për zbatimin e procedurës në mënyrën e përcaktuar, dhe veprimi në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, si dhe disa garanci të caktuara për sa i përket mandatit të anëtarëve. Sipas PSSP-së, HPCC i ka përmbushur këto kritere. Nga pikëpamja lëndore, HPCC kishte juridiksion ekskluziv për të zgjidhur disa ankesa private jokomerciale, me marrjen e vendimeve që ishin detyruese dhe që nuk i nënshtroheshin asnjë rishqyrtimi.

Nga pikëpamja strukturore dhe procedurale, PSSP-ja i referohet faktit se HPCC ishte i përbërë nga dy anëtarë ndërkombëtarë dhe nga një anëtar vendor, ku të gjithë duhej të ishin ekspert në fushën e tyre. Kualifikimet ligjore të anëtarëve siguronin një garanci të fuqishme të pavarësisë së tyre. Ata emëroheshin për një periudhë të pacaktuar dhe mund të largoheshin vetëm në rrethana të jashtëzakonshme. Ata nuk ishin pjesëtarë të stafit të KB-së apo të UNMIK-ut. PSSP-ja përfundon duke thënë se HPCC ishte tribunal, megjithëse me një natyrë "pothuaj gjyqësore", meqë aktiviteti i tij gjyqësor ishte i kufizuar në çështje të caktuara.

30. PSSP-ja gjithashtu argumenton se, derisa ishte e vërtetë se HPCC përgjithësisht vendosi për ankesat në bazë të parashtresave të shkruara dhe pa dëgjim publik dhe verbal, kjo nuk do të thotë se procedura ka shkelur nenin 6 § 1 të KEDNJ. Padyshim se ishte në interesin publik që marrja e vendimeve për ankesat nga HPCC përgjithësisht të bëhej pa dëgjim verbal në mënyrë publike, ashtu që HPCC t'i mundësohej të përballej dhe të zgjidhë një numër të madh të rasteve pronësore që ishin në pritje që nga viti 1999. PSSP-ja potencon se procesi i HPD dhe HPCC ishte një proces i zgjidhjes së ankesave në numër të madh. Gjatë hartimit të rregullores së punës të HPCC, gjerësisht u pranua fakti se miratimi i procedurave gjyqësore tradicionale adversiale, me dëgjime verbale dhe të drejta procedurale për elaborim, nuk mund të siguronin vendimmarrje të shpejtë, dhe duhej bërë baraspeshim ndaj të drejtave të ankuesve që ankesat e tyre të dëgjoheshin brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Si rrjedhim, rregullorja e punës duhej të bënte balancimin në mes të sigurimit të procedurës përkatëse dhe arritjes së shpejtësisë dhe efikasitetit. Sipas PSSP-së, korniza ligjore i siguronte ankuesit të drejta të konsiderueshme procedurale. Më në fund, për sa i përket kontekstit në të cilin vepronte HPCC, PSSP-ja tregon numrin e madh të kontesteve të vendosura nga HPCC gjatë ekzistimit të tij (29,000 konteste, të vendosura ndërmjet 2001 dhe 2007) dhe përqindjen e lartë të vendimeve të HPCC-së të cilët janë implementuar (98.5 %).

b) Vlerësimi i Panelit

31. Në pjesën përkatëse të nenit 6 § 1 të KEDNJ thuhet:

> "Në vendosjen e të drejtave civile dhe detyrimeve apo për ndonjë akuzë penale kundër tij, çdokush ka të drejtë në dëgjim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i themeluar me ligj […]."

32. Paneli thekson se PSSP-ja nuk e kundërshton zbatueshmërinë e nenit 6 § 1 të KEDNJ. Garancitë e kësaj dispozite zbatohen çdoherë kur duhet të vendosen "të drejtat civile dhe detyrimet" e personit. Paneli potencon se procedura pranë HPCC-së kishte të bënte me të drejtat e ankuesve lidhur me një pronë të caktuar banesore. Kështu që procedura kishte të bënte me vendosjen e të drejtave të tyre pronësore, një e drejtë e cila qartazi është e natyrës "civile" (shih Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), *Zander kundër Suedisë*, aktgjykim i 25 nëntorit 1993, *Publikime të Gjykatës*, Seria A, nr. 279-B, f. 40, § 27). Paneli konkludon se procedura është në kuadër të nenit 6 § 1 të KEDNJ (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (HRAP), *Vuçkoviç*, nr. 03/07, mendim i 13 marsit 2010, §§ 31-32).

A ishte HPCC"tribunal"

33. Përderisa ankuesit argumentojnë se HPCC nuk ishte "tribunal" në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ, Paneli përkujton se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se tribunali "karakterizohet në kuptimin lëndor të fjalës nga funksionet e tij gjyqësore, që do të thotë se vendos për çështjet brenda kompetencave në bazë të rregullave ligjore dhe pas procedurave të zbatuara në mënyrën e përcaktuar" (GJEDNJ (Grand Chamber), *Qiproja kundër Turqisë*, nr. 25781/09, aktgjykim i 10 marsit 2001, § 233, *KEDNJ*, 2001-IV). Përveç kësaj, tribunali në fjalë duhet të ketë juridiksion për shqyrtimin e të gjitha çështjeve faktike dhe juridike që janë relevante për kontestin që i është parashtruar (shih GJEDNJ, *Olujiç kundër Kroacisë*, nr. 22330/05, aktgjykim i 5 shkurtit 2009, § 38). Mirëpo, që një organ të cilësohet si "tribunal", neni 6 § 1 i KEDNJ nuk kërkon që ai të jetë "gjykatë e llojit klasik, i integruar në kuadër të makinerisë standarde gjyqësore të shtetit" (GJEDNJ, *Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i 28 qershorit 1984, *Publikime të gjykatës*, Seria A, nr. 80, f. 39, § 76).

34. Në këtë kontekst, Paneli thekson se HPCC nuk ishte gjykatë e llojit klasik. Ishte organ për shqyrtimin e ankesave në numër të madh i cili mori vendime të detyrueshme dhe të zbatueshme (shih Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/23 e datës 15 nëntor 1999 për themelimin e Drejtorisë për çështje banesore pronësore dhe Komisionit për ankesa banesore pronësore). Rregullat e procedurës për procedurat pranë HPCC ishin të përcaktuara në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60 të datës 31 tetor 2000 mbi kërkesat e pronës banesore dhe rregullorja e punës dhe e dëshmive e Drejtorisë për çështje banesore pronësore dhe e Komisionit të ankesave për çështje banesore pronësore, dhe HPCC vendosi për ankesat në një proces adversial në bazë të rregullave të drejtësisë. Këto vendime ishin të formës së prerë dhe ekzekutoheshin nga një organ administrativ, që ishte HPD, dhe më vonë AKP. Prandaj HPCC ishte gjyqësor për nga funksioni (shih HRAP, *Vuçkoviç*, cituar në § 32 lart, në § 34).

35. Për më tepër, HPCC ishte themeluar si organ i përhershëm, për të vendosur mbi ankesat e kategorive të përcaktuara qartë. Nuk mund të karakterizohet si organ i jashtëzakonshëm apo i themeluar aty për aty (*ad hoc)*, i krijuar për një qëllim specifik për të vendosur mbi ankesat e ankuesve.

36. Për rrjedhojë HPCC ishte tribunal, në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ. Kjo pjesë e ankesës është e pabazuar në shikim të parë, në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, dhe prandaj duhet të shpallet e papranueshme.

Mungesa e dëgjimit publik

37. Përderisa ankuesit ankohen për mungesën e dëgjimit publik në procedurën pranë HPCC, Paneli përkujton se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në përgjithësi mendon se e drejta për dëgjim publik nënkupton edhe të drejtën për dëgjim verbal. Mirëpo, kjo e drejtë nuk është absolute, dhe mund të ketë rrethana përjashtuese që e arsyetojnë mosmbajtjen e dëgjimit të tillë (shih, *p.sh.*, GJEDNJ (Grand Chamber), *Göç kundër Turqisë*, nr. 36590/97, aktgjykim i 11 korrikut 2002, § 47, *KEDNJ*, 2002-V). Gjykata gjithashtu ka përcaktuar se "karakteri i jashtëzakonshëm i rrethanave që mund të arsyetojë mosmbajtjen e dëgjimit verbal në esencë bie në llojin e çështjeve që duhet të vendosen nga gjykata kompetente nacionale, dhe jo në shpeshtësinë e situatave të tilla. Kjo nuk do të thotë se refuzimi i mbajtjes së një dëgjimi verbal mund të arsyetohet vetëm në raste të rralla" (GJEDNJ, *Miller kundër Suedisë*, nr. 55853/00, aktgjykim i 8 shkurtit 2005, § 29; GJEDNJ (Grand Chamber), *Jussila kundër Finlandës*, nr. 73053/01, aktgjykim i 23 nëntorit 2006, § 42, KEDNJ, 2006-XIV). Edhe pse gjykata shpesh i referohet natyrës

teknike të kontestit si një rrethanë që mund të arsyetojë trajtimin e një rasti me shkrim dhe jo me argumente verbale, ajo gjithashtu pranon se në fusha të caktuara është e kuptueshme që autoritetet nacionale të marrin parasysh "kërkesat për efikasitet dhe kursim të kohës", veçanërisht kur "mbajtja sistematike e dëgjimeve mund të jetë pengesë për kujdesin e posaçëm" që kërkohet në lloje të caktuara të rasteve, siç janë rastet e sigurisë sociale (shih, *p.sh.*, GJEDNJ, *Schuler-Zgraggen kundër Zvicrës*, aktgjykim i 24 qershorit 1993, *Publikime të Gjykatës*, Seria A, nr. 263, f. 19-20, § 58; GJEDNJ, *Döry kundër Suedisë*, nr. 28394/95, aktgjykim i 12 nëntorit 2002, § 41).

38. Duke iu kthyer rrethanave të rastit aktual, Paneli thekson se në raportin e tij përfundimtar, HPCC u shpreh si vijon për mungesën e përgjithshme të dëgjimit publik në procedurat e paraqitura pranë tij:

> "Palët nuk kishin të drejtë të japin dëshmi verbale përveç nëse thirreshin që ta bëjnë një gjë të tillë (…), meqë organizimi për pjesëmarrjen e disa mijëra ankuesve do të shkaktonte shterim të konsiderueshëm të resurseve dhe kohës, duke e bërë këtë të jetë në kundërshtim me të drejtat e ankuesve për mjet juridik brenda një kohe të arsyeshme. (…) Gjithashtu, fakti se ankuesit ishin dislokuar kudo (Republika Federative e Jugosllavisë) dhe më vonë u larguan do të rezultonte me vetëm disa ankues të cilët do të ishin në gjendje të ushtrojnë të drejtën për pjesëmarrje në dëgjime" (*Raporti përfundimtar i Komisionit të ankesave për çështje banesore pronësore Pri*shtinë, 2007, f. 55-56, gjendet në http://www.kpaonline.org/hpd/pdf/HPCC-Raporti përfundimtar. pdf).

39. Paneli i jep peshën e duhur këtij shpjegimi. Ai gjithashtu merr parasysh karakterin e procesit të HPCC për trajtimin e ankesave në numër të madh (shih § 34 lart). Në procedurën e përcaktuar në mënyrë specifike të trajtojë ankesat e tilla, e drejta për dëgjim publik nuk mund të kuptohet në të njëjtën mënyrë ashtu siç do të duhej të kuptohet në procedurën e rregullt pranë gjykatave të rregullta (krahaso, për sa i përket detyrimit të HPCC të jep arsyet në të cilat i bazon vendimet e tij, HRAP, *Anxhelkoviç*, nr. 11/07, mendim i 17 dhjetorit 2010, § 71).

40. Duke pasur parasysh situatën specifike që ekzistonte në Kosovë kur u vendos për ankesat e ankuesve nga HPCC, Paneli mund të pajtohet me PSSP-në se ishte në interesin publik që vendimet për ankesat HPCC-ja t'i merrte pa dëgjim publik. Ky aspekt i interesit publik ishte po ashtu i pranishëm në rastin e ankuesve.

41. Duke u bazuar në këtë që u tha më lart, Paneli zbulon se ka pasur rrethana që arsyetuan përjashtimin e dëgjimit publik. Prandaj, Paneli konkludon se nuk ka formë të shkeljes së nenit 6 § 1 të KEDNJ. Kjo pjesë e ankesave është po ashtu e pabazuar në shikim të parë dhe duhet të shpallet e papranueshme.

Pohimi për shkelje të nenit 13 të KEDNJ

a) Parashtresat e palëve

42. Ankuesit argumentojnë se, duke marrë në konsideratë themelimin e HPCC (nga UNMIK-u) dhe përbërjen e tij (dy anëtarë ndërkombëtarë dhe një anëtar vendor), HPCC nuk mund të konsiderohet autoritet nacional. Përkundrazi, ishte autoritet multinacional. Ata konkludojnë se nuk u është lejuar të ushtrojnë të drejtën e tyre për "mjet të efektshëm pranë një autoriteti nacional", ashtu siç garantohet me nenin 13 të KEDNJ.

43. PSSP-ja argumenton se procedura pranë HPD/HPCC përbënte një mjet të efektshëm, për qëllimet e nenit 13 të KEDNJ. Ai thekson se, pasi që HPCC kishte marrë vendim në shkallën e parë, ankuesit kishin po ashtu të drejtë në rishqyrtim të rastit. PSSP-ja gjithashtu i referohet shoqërisë pas konfliktit që karakterizoi Kosovën kur u themeluan HPD dhe HPCC. Ai argumenton se kjo situatë unike duhet marrë parasysh kur të bëhet vlerësimi i përpjekjeve të ndërmarra nga UNMIK-u në të gjitha aspektet e qeverisjes civile.

b) Vlerësimi i Panelit

44. Sipas nenit 13 të KEDNJ "çdokush të drejtat dhe liritë e të cilit ashtu siç janë përcaktuar në këtë Konventë shkelen, ka të drejtë në mjet të efektshëm pranë një autoriteti nacional qoftë edhe kur shkelja bëhet nga persona të cilët veprojnë në cilësi zyrtare".

45. Duke pretenduar se neni 13 i KEDNJ është i zbatueshëm në procedurën pranë HPCC, Paneli thekson se ankuesit nuk e kontestojnë efektivitetin e këtyre procedurave si një mjet për kompensimin e shkeljes së pohuar të të drejtave të tyre të njeriut. Ata vetëm ankohen për faktin se HPCC siç pohojnë nuk përbën "autoritet nacional".

46. Neni 13 i KEDNJ garanton disponueshmërinë e një mjeti në nivel nacional për të zbatuar përmbajtjen e të drejtave dhe lirive të KEDNJ në cilëndo formë që këto të drejta mund të sigurohen (Shih *p.sh*., GJEDNJ (Grand Chamber), nr. 27765/09, *Hirsi Jamaa dhe të Tjerët kundër Italisë*, aktgjykim i 23 shkurtit 2012, § 197; GJEDNJ (Grand Chamber), nr. 26828/06, *Kuriç dhe të Tjerët kundër Sllovenisë*, aktgjykim i 26 qershorit 2012, § 369).

47. Në një situatë siç është ajo në Kosovë, ku u vendos prania civile ndërkombëtare sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 të datës 10 qershor 1999, për të siguruar një administratë të përkohshme, "autoriteti nacional" në kuptim të nenit 13 të KEDNJ pashmangshëm duhet të jetë autoritet i themeluar nga ajo administratë ndërkombëtare, apo së paku të jetë nën kontrollin e saj.

48. Paneli konkludon se HPCC mund të konsiderohet "autoritet nacional", në kuptim të nenit 13 të KEDNJ. Prandaj, kjo pjesë e ankesës është po ashtu e pabazuar në shikim të parë, dhe duhet të shpallet e papranueshme.

Pohimi për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ

a) Parashtresat e palëve

49. Ankuesit në përgjithësi argumentojnë se ata kanë qenë të privuar nga pronat e tyre pa pasur ndonjë "interes publik", dhe se kjo është shkelje e "parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare", në kuptim të nenit 1, paragrafi i parë, fjalia e dytë, Protokolli nr. 1 i KEDNJ.

50. Në mënyrë më specifike ata argumentojnë se sipas ligjit në fuqi në atë kohë (Ligji mbi marrëdhëniet banesore, *Gazeta Zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës*, nr. 11/93, 29/86 dhe 42/86), z. H.S. kishte të drejtë vetëm ta shfrytëzojë banesën përkohësisht, për aq kohë sa ai të ushtronte funksionet publike brenda Kuvendit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Sipas ankuesve, ai asnjëherë nuk e fitoi të drejtën e posedimit. Kur funksionet e tij zyrtare përfunduan, të drejtat e tij lidhur me banesën pushuan së ekzistuari gjithashtu. Ankuesit gjithashtu ankohen se sipas ligjit në fuqi në atë kohë, subjekti që ia ka ndarë banesën z. H.S. "për shfrytëzim zyrtar", nuk ka pasur mundësi ta shndërrojë atë në banesë "për shfrytëzim banesor". Kjo banesë më vonë

është shndërruar në banesë për banim, dhe më vonë i është dhënë për shfrytëzim të ndjerës znj. Dekiç. Ankuesit konkludojnë se HPCC nuk mund të vendoste se z. H.S. kishte ankesë valide të "kategorisë A".

51. PSSP-aj argumenton se ankuesit nuk janë privuar nga posedimi i banesës në fjalë. Përkundrazi, është marrë vendim, në pajtim me ligjin, se z. H.S. ishte poseduesi i drejtë i banesës. Nëse ankuesit do të konsideroheshin të privuar nga posedimi i banesës, kjo është pasojë e natyrshme e vendimit të marrë nga HPCC se ata nuk ishin personat të cilët kishin të drejtë prioritare për banesën.

b) Vlerësimi i Panelit

52. Në nenin 1, paragrafin e parë, të Protokollit nr. 1 të KEDNJ thuhet:

> "Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë të gëzojë pronën e tij në mënyrë të papenguar. Askush nuk do të privohet nga prona e tij përveç kur është në interesin publik dhe duke iu nënshtruar kushteve të parapara me ligj dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare."

53. HPCC e pranoi se të dy ankuesit kishin interesa të caktuara pronësore lidhur me banesën në fjalë (shih § 18 lart). Prandaj, Paneli pajtohet se ankuesit mund të thirren në mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1.

54. Përderisa ankuesit argumentojnë se HPCC nuk kishte të drejtë në konstatimin se z. H.S. kishte ankesë valide të "kategorisë A", Paneli përkujton se kushti i parë dhe më i rëndësishmi i nenit 1 të Protokollit nr. 1 është se çdo ndërhyrje e ndonjë autoriteti publik me gëzimin e papenguar të pronës duhet të parashihet me ligj (*shih, p.sh.*, GJEDNJ (Grand Chamber), nr. 38433/09, *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano kundër Italisë*, aktgjykim i 7 qershorit 2012, § 187).

55. Në rastin aktual, ndërhyrja në interesat pronësore të ankuesve rezulton nga zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60 të datës 31 tetor 2000 për ankesat pronësore banesore dhe Rregullorja e punës dhe e dëshmive e Drejtorisë për çështje banesore pronësore dhe Komisioni i ankesave për çështje banesore pronësore. Kjo rregullore, në mes tjerash, parashihte kthimin e banesave në pronësi shoqërore ankuesve të cilët për banesat e tilla gëzonin të drejtën e posedimit, që ishte pezulluar si pasojë e diskriminimit (neni 4). HPCC gjeti se z. H.S. e kishte një të drejtë të tillë të posedimit, që mbizotëronte mbi të drejtat e ankuesve. Prandaj, ekzistonte një bazë ligjore për këtë ndërhyrje.

56. Ankuesit e kontestojnë vendimin e HPCC, mbi bazën se sipas nenit 7 të Ligjit mbi marrëdhëniet banesore, i cili ishte në fuqi në vitin 1988, dispozitat e këtij ligji nuk zbatoheshin për banesat që përdoreshin për qëllime zyrtare, *d.m.th.* banesat që ishin ndarë për një detyrë dhe funksion të caktuar zyrtar dhe ishin të definuara si të tilla. Shfrytëzuesit e banesave të tilla nuk e kishin fituar të drejtën e posedimit. Ata gjithashtu thirren në nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60, që përmban definicionin e "të drejtës poseduese". Ky nocion mbulon të drejtën e shfrytëzimit, që në mes tjerash është mundësuar me Ligjin mbi marrëdhëniet banesore, kurse "e drejta për shfrytëzimin e banesave për qëllime zyrtare (banesa për shërbim)" në mënyrë eksplicite është përjashtuar nga ky ligj.

57. Ankuesit në esencë kërkojnë nga Paneli të rishqyrtojë konstatimet e HPCC, nga pikëpamja faktike dhe juridike, lidhur me ekzistimin e të drejtës poseduese për sa i përker z. H.S. Mirëpo, nuk është detyrë e Panelit të merret me lajthitjet faktike apo juridike të cilat

pohohet se janë bërë nga HPCC, përveç nëse ata kanë shkelur të drejtat dhe liritë fundamentale. Përndryshe, Paneli do të vepronte si gjykatë e apelit mbi HPCC dhe do të shpërfillte kufizimet e fushëveprimit të tij për rishqyrtim (krahaso GJEDNJ (Grand Chamber), nr. 30544/96, *García Ruiz kundër Spanjës*, aktgjykim i 21 janarit 1999, § 28, *KEDNJ*, 1999-I; GJEDNJ (Grand Chamber), nr. 38433/09, *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano kundër Italisë*, cituar lart, § 197; HRAP, *Mitroviç*, nr. 06/07, mendim i 17 dhjetorit 2010, § 65). Paneli është i kënaqur që HPCC shqyrtoi me kujdes argumentet në të cilat thirren ankuesit dhe i dha arsyet për vendimin e tij. Nuk ka indikacion për arbitraritet apo padrejtësi.

58. Përderisa ankuesit argumentojnë se ndërhyrja në të drejtat e tyre nuk ishte në "interesin publik" dhe se shkeli "parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare", ankesat nuk janë të vërtetuara.

59. Paneli konkludon se kjo pjesë e ankesave është po ashtu e pabazuar në shikim të parë, dhe duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

SHPALL ANKESAT TË PAPRANUESHME.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Paul LEMMENS
Kryetar